

PROCESVERBAL
nga seanca e 14-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele,
mbajtur më 5.3.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional: mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 14-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 13 –të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 10.4.2023.
2. Shqyrtimi i Raporteve Tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 janari deri më 31 mars 2023.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
4. Propozim për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj SHTR T.V. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.
5. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR TV SHUTEL nga Shkupi.
6. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR RURBAN FM RADIO nga Shkupi .
7. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Licenca për Firewall .
8. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Materiale dhe mjete IT konsumuese të imëta dhe vegla pune .

9. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Shtypje me qira .
10. Propozim për dhënie miratim për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit: Punë ndërtimore - zeytare për rehabilitim në objekt, me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për Furnizime Publike .
11. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e seancës së 13 -të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 10.4.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Petrushevski, lidhur me Raportet tremujore për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 janari deri më 31 mars 2023, sqaroi se Këshilli nuk voton për miratimin e tyre, por kanë mundësi të diskutojnë përmbajtjen e tyre për informim të detajuar në lidhje me punën e Agjencisë. Lidhur me Raportin e tremujorit të parë, ai tha se do të veçonte tri gjëra që i lanë përshtypje të veçantë. Fillimisht ai tha se në këtë periudhë aktiviteti ndërkombëtar i Agjencisë ka qenë vërtet i gjerë, krahas aktiviteteve standarde. Gjithashtu, institucioni kishte komunikim të shtuar me publikun për sa i përket njoftimeve dhe dënimeve të ngjarjeve të papranueshme për lirinë e medias, dhe kjo e bën të lumtur që është e njëjtë ndaj të gjitha subjekteve në shtet. Gjëja e tretë që ai vuri re është se Agjencia vërtet ka një bashkëpunim të shkëlqyer dhe të pasur me institucionet e tjera në vend. Ai tha se nuk ka vërejtje, Raporti është standard i mirë, dhe e vlerëson punën e Agjencisë si shumë të mirë gjatë kësaj periudhe.

Z. Ajdini tha se Raportet ishin bërë mirë. Ato përfshijnë të gjitha aktivitetet që Agjencia kishte bërë në tre muajt e parë të vitit. Për disa prej tyre anëtarët e Këshillit janë të informuar vazhdimisht, ndërsa për disa kanë qenë të përfshirë në mënyrë në vendimmarrjen e seancave të Këshillit.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilia Janevska, ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJPK eksport-import Saraj Shkup për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se me mbikëqyrjen e rregullt realizuar më 2 mars të këtij viti, është konstatuar shkelje e detyrimit për transmetimin e së paku 30% të veprave audiovizuale maqedonase në nivel ditor dhe gjysma e atij 30% që të transmetohet nga ora 07:00 deri në 19:00. Tek transmetuesi është konstatuari se në vend të 30%, ai transmetoi 19,93%, që është 2 orë 9 minuta e 42 sekonda më pak program i krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase. Gjithashtu, nuk ka përqindje të plotë të mjaftueshme në periudhën nga ora 7 deri në orën 19, gjegjësisht në këtë periudhë ka transmetuar 1 orë 20 minuta e 51 sekonda më pak se minimumi i kërkuar. Për këto arsye, në pajtim me Ligjin, propozohet që të shqiptohet masë vërejtje publike me afat

për harmonizimin me Ligjin prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse transmetuesi ka respektuar detyrimet ligjore.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-1389/1 të datës 27.3.2023 dhe njëzëri konstatoi ndaj SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafi (1). dhe (3) nga LSHMAAV sepse më 2 mars 2023 nuk ka transmetuar së paku 30% të programeve të krijuara burimor si vepra audiovizuele maqedonase dhe as nuk ka transmetuar së paku gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, transmetuar në periudhën nga ora 7,00 deri në orën 19:00.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele .

Sektorii për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë AkvVendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektorii për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Akvendimin për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektorii për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojnë Aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Udhëheqësja Janevska ka shpjeguar Propozimin për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ndaj SHTR TV. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP për shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se më 9 mars të këtij viti, këtij transmetuesi i është shqiptuar masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92, paragrafit (1) të LSHMAAV, përkatësisht për detyrimin për transmetim së paku 30% të veprave audiovizuele maqedonase në nivel ditor. Me mbikëqyrjen e kontrollit të kryer më 11 prill të këtij viti, është konstatuar se TV Kaltrina nuk ka mënjanuar shkeljen. Në vend të 30%, nga mbikëqyrja është konstatuar 26,98%, pra Televizioni Kaltrina ka transmetuar për 30 minuta e 20 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase. Në pajtim me Ligjin, propozohet ngritja e procedurës për kundërvajtje.

Z. Ajdini tha duke qenë se kemi të bëjmë me shkelje, nga materialet shihet se nuk ka paraqitur deklaratë dhe pyeti nëse është kontaktuar?

Udhëheqësja Janevska sqaroi se kjo shkelje ka ndodhur që nga viti i kaluar kur i është shqiptuar masa vërejtje publike. Mbikëqyrja e kontrollit u krye në fillim të këtij viti, por meqenëse ishte mbikëqyrja e parë e vitit, atij në vend të kundërvajtjes iu shqiptua edhe një herë masa vërejtje publike. Me mbikëqyrjen e tretë të kontrollit, transmetuesi sërish nuk është në përputhje me ligjin. Ajo deklaroi se është kontaktuar por ende nuk është në përputhje me nenin 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor me nr. 10-1931/1 datë 27.4.2023 të SHTR TV. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP dhe ka konstatuar shkelje të nenit 92 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër SHTR TV. KALTRINA Mazar Tateshi, Strugë SHPKNJP ka kërkuar iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja e kontrollit është konstatuar se më 11 prill 2023, nuk ka transmetuar së paku 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase .

Spektori për çështje juridike dhe frokurim publik të përpiloi Kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektoeit për planifikim strategjik dhe të drejta e autorit, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, sqaroi Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR TV SHUTEL. Ajo shpjegoi se njoftimi është i rregullt dhe i plotë. Bëhet fjalë për ndryshim të planifikuar që nënkupton dorëheqjen e pronarit ekzistues të televizionit dhe aderimin e një personi tjetër fizik. Spektori bëri kontroll në Regjistrin Qendror të RSM-së dhe përcaktoi se personi që duhet të jetë pronari i ri shfaqet si themelues i një shoqërie tregtare që është regjistruar për aktivitet që nuk bie ndesh me aktivitetet e cekura në LSHMAAV. Meqenëse nuk ka pengesa Ligjore, propozohet të lejohet ndryshimi i planifikuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim, ku lejohet ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare mer veprimtari radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, me tekstin e propozuar në vendim.

Ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë së Shoqërisë Tregtare me veprimtari radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup nuk krijojnë koncentrim të kundërligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht se ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalimin e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikon Aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 6

Udhëheqësja e Spektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr.Magdalena Davidovska Dovleva, ka shpjeguar Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR URBAN FM RADIO nga Shkupi. Ajo ka thënë se personi fizik që duhet të jetë pronari i ri i këtij radiostacioni figuron si themelues, administrator, person i autorizuar i disa subjekteve të tjera juridike, por asnjëri prej tyre nuk kryen veprimtari që do të krijonte përqendrim të paligjshëm mediatik. Duke qenë se nuk ka pengesa ligjore, propozohet miratim i ndryshimit të planifikuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim ku lejohet ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup, me tekstin e propozuar në vendim.

Ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive URBAN FM RADIO SHPKNJP Shkup nuk krijojnë koncentrim të kundërligjshëm

mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me nenet 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojnë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska sqaroi Propozimin për dhënie miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Licencë për Firewall. Ajo shpjegoi se sipas shumës së mjeteve të parashikuara do të zbatohet si furnizim me vlerë të ulët, që do të thotë se shpallja do të publikohet vetëm në sistemin elektronik për prokurimit publik. Ajo tha se të gjitha të dhënat e nevojshme gjenden në materialet e dorëzuara sipas pikës.

Z. Petrushevski tha se bëhet fjalë për furnizim teknik për të cilin ka mundësi të paraqiten më shumë oferta. Pajisja është një dhe është blerje e nevojshme që Agjencia të marrë licencë ligjore.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Licenca për Firewall.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Licenca për Firewall është paraparë dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale me nr.05-4766/1 datë 23.12. 2022, ndërsa fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 8

Udhëheqësja Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Materiale dhe mjete informatike shpenzuese dhe të vogla. Ajo shpjegoi se do të kryhet si blerje me vlerë të ulët dhe kontrata që do të rezultojë do të jetë në kohëzgjatje prej 1 viti. Ajo tha se të gjitha të dhënat e nevojshme gjenden në materialet e dorëzuara sipas pikës.

Z. Petrushevski tha se nga materialet mund të konstatohet se Agjencia nuk është e obliguar t'i shpenzojë të gjitha mjetet e planifikuara por sipas nevojës.

Udhëheqësja Mitrevska u përgjigj se blerja është caktuar që mjetet të shpenzohen në mënyrë të njëpasnjëshme, gjegjësisht aq sa ka nevojë Agjencia për materiale dhe mjete të imëta TI.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik-mallra: Materiale dhe mjete TI konsumuese dhe të imëta.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për artikullin-mallra: Materiale dhe mjete informatike të konsumueshme dhe të imëta është paraparë dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/ 1 të datës 23.12.2022, kurse mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 9

Udhëheqësja Mitrevska sqaroi Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shtypje me qira. Ajo shpjegoi se sipas shumës së mjeteve do të zbatohet si procedurë e hapur e thjeshtuar dhe kontrata që do të rezultojë do të lidhet për një periudhë 2 vjeçare. Shpallja do të publikohet në sistemin elektronik për furnizim publik dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së. Dokumentacioni i plotë dhe informacioni për këtë furnizim publik mund të gjenden në përmbajtjen e materialeve të dorëzuara nën pikë.

Z. Petrushevski shpjegoi se ky është afati minimal për këtë lloj furnizimi sepse për këtë lloj furnizimi (prokurimi) zakonisht përdoret kontratë në kohëzgjatje prej 3 vitesh që të ketë interes ofruesi i printerëve, gjegjësisht sepse ai i sjell pajisjet e tij që të jenë fitimprurëse për të sepse janë të amortizuara.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shtypje me qira.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Shtypje me qira është paraparë dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale me nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, pra do të sigurohen më tej nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2024.

Pika 10

Z. Trajçevski, në lidhje me Propozimin për dhënie miratim për marrjen e vendimit për prokurimin e shërbimit: Punë ndërtimore - zeytare për rehabilitim në objekt, me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim (prokurim) publik.,sqaroi se në vende të caktuara të katit të dytë dhe në garazhin ku janë parkuar makinat zyrtare, rrjedh ujë atmosferik. Disa herë punonjësit u përpoqën të mënjanonin problemin, por duke qenë se është sipërmarrje më e madhe, nevojitet ndihmë profesionale. Për këtë arsye është e nevojshme të zgjidhet kompani që do të kryejë punë ndërtimore-zejtarie për rehabilitim në objekt.

Udhëheqësja Mitrevska sqaroi se bëhet fjalë për furnizim me vlerë të vlerësuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik. Për zgjidhjen (mënjanimin) e problemeve të caktuara janë dorëzuar 3 oferta për prokurim shërbimi: Punët ndërtimore-zejtare dhe oferta e zgjedhur ka qenë ekonomikisht më fitimpruëse për Agjencinë dhe është dorëzuar për inspektim në materiale. Edhe pse Ligji për furnizim publik nuk parasheh obligim që ky prokurim të kryhet në këtë mënyrë, Agjencia ka dashur të jetë transparente dhe ka ofruar 3 oferta.

Këshilli i Agjencisë dha miratim që drejtori i Agjencisë të marrë vendim për prokurimin e shërbimit: Punët ndërtimore-zejtare për rehabilitim në objektin ku ndodhet Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale në Shkup, me vlerësim të vlerësuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për prokurime publike, e cila nuk do të kalojë shumën prej 58.000,00 denarë pa TVSH të llogaritur.

Për zbatimin e shërbimit të mësipërm, fondet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 11

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-1946

19.05.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**